



РАПОРТ ВЈЕТОР

2017



R A P O R T

RRETH PUNËS SË DREJTORISË SË DOGANAVE
GJATË VITIT

2017







FJALIM HYRËS

5

I. KORNIZA LIGJORE

9

I.1. LEGJISLACIONI DOGANOR

9

I.2. AKCIZA

9

I.3. RREGULLORE TJETËR QË NDIKON NË PUNËN DOGANORE

10

II. INTEGRIMI NË BE

11

II.1. SISTEM I PËRBASHKËT TRANSITI I VENDEVE TË BE-së DHE EFTA-s

11

II.2. DOGANA 2020 – PROGRAMET E KOMISIONIT EVROPIAN

12

II.3. PROJEKTE MBËSHTETUR NGA INSTRUMENTI PËR NDIHMË

PARA-ANËTARËSIMIT (IPA)

12

PROJEKTE TË PËRFUNDUARA IPA

12

PROJEKTET IPA NË PROGRES

12

III. BURIMET NJERËZORE NË DREJTORINË E DOGANAVE

13

III.1. KAPACITET I RI PËR ZHVILLIMIN E PERSONELIT KOMPETENT

14

III.2. TRAJNIME DHE PËRSOSJE PROFESIONALE GJATË VITIT 2017

14

III.3. KURSE RRETH TË MËSUARIT ELEKTRONIK

14

III.4. INTEGRITETI

15

III.5. REVIZIONI I BRENDSHËM

16

IV. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I PROCEDURAVE DOGANORE

17

IV.1. KUSHTET PËR ZBATIMIN E FORMALITETEVE DOGANORE

17

IV.1.1. OPERATORI I AUTORIZUAR EKONOMIK – OAE

18

IV.1.2. KONTROLLE TË PËRBASHKËTA KUFITARE – PROJEKTI “ONE STOP SHOP”

18

IV.2. E-DOGANA

18

IV.2.1. SOFTUER I RI PËR PËRPUNIMIN E DEKLARATAVE DOGANORE

18

IV.2.2. EXIM

19

IV.3. FUSHËVEPRIMI I PUNËS

19

IV.3.1. LICENCAT DOGANORE DHE TË AKCIZËS DHE LICENCAT GJATË VITIT 2017

19

IV.3.2. DEKLARATA TË PËRPUNUARA DOGANORE

20

IV.4. QARKULLIMI I AUTOMJETEVE MOTORIKE TË MALLRAVE (AMM)

NË PIKAT E KALIMEVE KUFITARE GJATË VITIT 2017

20

IV.5. PAGIMI TË HYRAVE

21

V. KONTROLLI DHE ZBATIMI I LIGJEVE

23

V.1. KONTROLLI DOGANOR DHE KONTROLLI TJETËR

23

V.1.1. KONTROLLI DOGANOR FIZIK

23

V.1.2. KONTROLLI I DOKUMENTUAR DOGANOR

28

V.2. REZULTATE TË KONTROLLIT POST-DOGANOR

28

V.3. PAGESA SHITESË E DETYRIMEVE TË IMPORTIT DHE AKCIZËS

28

V.4. KALLËZIME PENALE

28

V.5. KUNDËRVAJTJE DOGANORE, ME DEVIZA DHE AKCIZA

29

V.6. PJESËMARRJE NË OPERACIONE NDËRKOMBËTARE

29

V.7. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE

29

VI. TRANSPARENCË DHE BASHKËPUNIM NË FUSHËN E DOGANËS

31

VI.1. NGJARJE TË RËNDËSISHME

31

VI.2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

32

VI.3. BASHKËPUNIMI BILATERAL

33

VI.4. BASHKËPUNIMI I KOMUNITETIT TË BIZNESIT

34

VI.5. INTERNET DHE INTRANET

35





Të nderuar,

Avancimi i rezultateve të cilat i kemi arritur gjatë vitit të kaluar reflektojnë përkushtimin tonë të qëllimit që del nga misioni i Drejtorisë së doganave rreth mbrojtjes së interesave financiare të shoqërisë, zhvillimit ekonomik dhe lehtësimit të tregtisë.

Roli kryesor i Drejtorisë së doganave është pagesa e detyrimeve të importit dhe atyre tatimore, por njësoj rol i rëndësishëm është edhe mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve, si dhe siguria e shoqërisë në përgjithësi.

Drejtoria e doganave qëndron në radhë të parë në mbrojtje të ekonomisë dhe interesave të shtetit, kështu duke luftuar kundër shumë aktiviteteve ilegale dhe të ndaluara, në drejtim të sigurimit të mirëqenies së përgjithshme. Prioriteti i saj primar është sigurimi i rritjes së qëndrueshme ekonomike përmes rritjes së konkurrencës dhe investimeve, përmirësimit të kushteve të mirëmbajtjes së biznesit dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë përfaqësuesit e komunitetit të biznesit. Ky qëllim do të arrihet përmes lehtësimit të tregtisë dhe vendosjes së procedurave të thjeshtësuara dhe transparente në domenin e punës sonë.

Ne jemi të vetëdijshëm se kushti themelor për arritjen e vizionit për të qenë një Drejtori e doganave lider në rajon i cili do të jetë plotësisht i harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian, është modernizimi i administratës, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të teknologjisë së informacionit, përmirësimi i kushteve të punës dhe mirëmbajtja e nivelit të lartë të standardeve për integritetin e të punësuarve.

Zbatimi i standardeve të larta në punën tonë me qëllim të arritjes së efikasitetit, efektivitetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit përmes investimeve të vazhdueshme në promovimin dhe zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat janë forca lëvizëse për arritjen e qëllimeve të parapara strategjike.

Angazhimi ynë për të arritur një nivel të lartë të besimit në opinion do të vazhdojë përmes zbatimit të duhur të legjislacionit, duke siguruar barazinë dhe drejtësinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien, si dhe transparencën dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit.

Rezultatet e arritura konfirmojnë angazhimin, entuziazmin dhe punën sistematike të të punësuarve në Drejtorinë e doganave.

Shfrytëzoj rastin të shpreh vlerësimin tim për suksesin e të gjithë të punësuarve të Drejtorisë së doganave dhe t'i ftoj ata së bashku për të ecur përpara, me angazhim dhe entuziazëm më të madh për sukses më të madh në vitet që vijnë.

*Me respekt,
Drejtor
m-r. Gjoko Tanasoski*

HARTË STRATEGJIKE E DREJTORISË SË DO

VIZI

Të jemi Drejtori e doganave lider në rejon që do të ofrojmë shërbime të jetë plotësisht e harmonizuar me



Lehtësimit i tregtisë

- Harmonizim me Bashkimin Evropian
- Lehtësimit dhe përsheptim i qarkullimit të mallrave dhe udhëtarëve
- Procedura të thjeshtësuara dhe formalitete të paraparë
- Qasje e orientuar drejt klientit dhe partneritetit



Pagesë e të hyrave dhe mbrojtja e interesave financiare

- Efikasitet i pagesës së të hyrave
- Përmirësim i sistemit për menaxhim me akciza
- Përforsim në fushën e „Vlerës, tarifës dhe origjinës”

MISI

Ti mbrojmë interesat financiare dhe shoqërinë, njëkoh bashkëpunimit, lehtës

GANAVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

ONI

oj mbështetje të fuqishme ndaj ekonomisë dhe që do të përmbushin standardet e Bashkimit Evropian

- Kontrolle efektive dhe efikase
- Përforcim në fushën "ndalesa dhe kufizime"
- Përforcim i luftës kundër krimit dhe mashtrimeve doganore
- Marrëdhënie të qëndrueshme dhe sistem i sigurt i prokurimeve



Mbrojtja e shoqërisë

- Përforcim i MRNJ
- Pengim i sjelljes joadekuate dhe konfliktit të interesave
- Zhvillim i TI
- Përmirësim i proceseve të punës
- Menaxhim efikas dhe transparent me financat publike
- Transparencë



Modernizim

ONI

është duke mbështetur zhvillimin ekonomik përmes reformave të strukturimit dhe modernizimit



I. KORNIZA LIGJORE

I.1. LEGJISLACIONI DOGANOR

Drejtoria e doganave në mënyrë të vazhdueshme punon në thjeshtësimin e procedurave doganore, rritjen e konkurrencës së ekonomisë së vendit dhe reduktimin e shpenzimeve të operatorëve ekonomik, si dhe harmonizim të legjislacionit doganor me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2017 janë sjellë këto ndryshime dhe plotësime të akteve ligjore dhe atyre nënligjore:

- Janë publikuar **4 Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për shpërndarjen e mallit të caktuar të Nomenklaturës së kombinuar mbështetur me rregulloret e Komisionit Evropian.**
- Është publikuar **Vendimi për harmonizim dhe ndryshim të Tarifës doganore për vitin 2018**
- Janë publikuar **Listat për kuota për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2018** për import të mallit. Shpërndarja e kuotave kryhet sipas parimit “i pari i ardhur, përdorues i parë” përmes EXIM sistemit ku importuesve u mundësohet import pa doganë me detyrime të reduktuara në kuadër të kuotave të caktuara sasiore.

I.2. AKCIZA

Gjatë fundit të vitit 2017 është sjellë **Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të akcizave** që zbatohet nga data 1 janar 2018. Me ndryshimet parashihet rritje e akcizës së vajit për karburant për 3 denarë.



I.3. RREGULLORE TJETËR QË NDIKON NË PUNËN DOGANORE

Protikolli shtesë 5 i Marrëveshjes për ndryshim dhe aderim në Marrëveshjen e Evropës qendrore për tregti të lirë aprovuar në maj të vitit 2017 në Beograd, në prani të të gjitha CEFTA palëve, ndërsa i ratifikuar në janar të vitit 2018, mundëson lehtësim në tregti që do të arrihet përmes vendosjes së mjeteve të transitit dhe procedurave të thjeshtësuara doganore dhe tregtare për eliminimin e rreziqeve të mundshme gjatë eksportit.

Për shkak të mundësive për harmonizim dhe lehtësim të procedurave për eksport dhe import të mallrave, vlerësohet se ky Protokoll do të përmirësojë ndjeshëm qarkullimin e mallrave, dhe kështu tregtinë në rajon. Rrjedhimisht, pritet rritja e tregtisë së Republikës së Maqedonisë, dhe përveç në tregun rajonal, Protokolli Shtesë duhet të lejojë një shkëmbim më të madh sidomos me tregjet e Bashkimit Evropian.

II. INTEGRIMI NË BE

Në vitin 2017, një vend i veçantë në axhendën e Drejtorisë së doganave janë aktivitetet që synojnë harmonizimin e përhershëm dhe zbatimin e legjislacionit doganor të BE-së në Republikën e Maqedonisë, përbushjen e kërkesave teknike dhe organizative, zhvillimin e kapaciteteve administrative, si dhe zgjerimin e vetëdijes publike për mënyrën dhe filozofinë e funksionimit të Bashkimit Doganor.

II.1. SISTEM I PËRBASHKËT TRANSITI I VENDEVE TË BE-SË DHE EFTA-S

Konventat në procedurën e përbashkët të transimit dhe thjeshtësimi i formaliteteve në tregtinë e mallrave sigurojnë vetëm lëvizjen e mallrave brenda vendeve anëtare nga një pikë hyrje deri në pikën e përfundimit të procedurës së transimit, pavarësisht sa vende dhe pika të kalimit kufitar duhet të kenë mallrat për transit. Deklarata e transimit elektronik me të cilin është iniciuar një procedurë transiti në çdo shtet anëtar të Konventës për një procedurë të përbashkët transiti është i pranueshëm për të gjitha shtetet palë në Konventë.

Gjatë vitit 2017:

- Janë përpunuar gjithsej 64,830 deklarata doganore në procedurën e përbashkët (të transimit nga Republika e Maqedonisë në BE dhe vendet e EFTA-s);
- Nga zyrat doganore të huaja janë pranuar gjithsej 20,059 lëvizje transiti, në të cilat zyrat tona janë shënuar si zyra të destinacionit (transit nga vendet e BE-së dhe EFTA-s për Republikën e Maqedonisë);
- Në territorin e Republikës së Maqedonisë kanë transitar gjithsej 39.893 lëvizje transiti ;
- Janë lëshuar gjithsej 134 aprovime të operatorëve ekonomik me të cilët mundësohet qasje drejt Sistemit të ri të kompjuterizuar të transimit (SRKT) dhe 55 aprovime të detyruesve kryesor për përdorim të garancisë bankare në procedurë të përbashkët transiti.

II.2. DOGANA 2020 – PROGRAMET E KOMISIONIT EVROPIAN



Gjatë vitit 2017 në 26 evente (trajnime, seminare, mbledhje pune, grupe pune) kanë marrë pjesë 38 pjesëmarrës.

II.3. PROJEKTE MBËSHTETUR NGA INSTRUMENTI PËR NDIHMË PARA-ANËTARËSIMIT (IPA)

Në kuadër të Programit Kombëtar për shfrytëzimin e fondeve nga Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA), Drejtoria e doganave është përfitues i fondeve për projektet në vijim:

Projekte të përfunduara IPA

➤ Projekti “Asistencë teknike për përgatitjen e projektit ideor, projektit bazë dhe dokumentacionit të tenderit për punimet e ndërtimit të VK Tabanoc dhe Qafëthanë (IPA 2011). Projekti përfundoi me sukses në shtator 2017.

➤ Projekti “Rindërtim i objekteve doganore në pikën e kalimit kufitar qarkullimi i udhëtarëve Tabanoc” (IPA 2012) → qëllimi i zgjerimit dhe zëvendësimit të terminalit doganor ekzistues për import dhe eksport të mallrave për 4,000 metra katrorë shtesë; ndërtimi i dy korsive në VK për dalje nga Republika e Maqedonisë; ndërtimi i objekteve shoqëruese. Projekti u përfundua në vitin 2017. Pritet të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e frekuencës së kalimit dhe përshejtimin dhe lehtësimin e shkëmbimit të mallrave dhe transportit përgjatë Korridoreve Pan-Evropiane 10;

Projektet IPA në progres

➤ Projekti “Rindërtimi i objekteve për zhdoganim dhe inspektim në VK “Qafëthanë” IPA 2013) → filloi në tetor 2017. Parashikohet ndërtimi i një terminali të ri doganor prej 9,500 metra katrorë, rrugë hyrëse, lehtësirat doganore dhe organet e tjera inspektuese që janë paraparë për rindërtimin e objekteve ekzistuese në pikën më me frekuencë të kalimit kufitar me Republikën e Shqipërisë. Me rikonstrukcionin e kalimit, përgjatë Korridoreve Pan-Evropiane 8 krijohen kushte për përshejtimin e mëtejshëm të trafikut ndër-kufitar. Përfundimi i punëve ndërtimore është parashikuar në fund të vitit 2018.

➤ Në gusht të vitit 2017, filloi zbatimi i projektit “Forcimi i kapaciteteve operacionale dhe institucionale të Drejtorisë së doganave” (IPA 2013) filloi të rrisë efikasitetin në zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit doganor nëpërmjet kontrolleve më efikase dhe të synuara; përforcimi i lehtësirave doganore; aplikimi i metodave dhe mjeteve laboratorike moderne; Lehtësimi i tregtisë duke përmirësuar analizën e rrezikut në përputhje me standardet e BE-së. Në kuadër të projektit në vitin 2018 do të sigurohen pajisje moderne për laboratorin doganor;

III. BURIMET NJERËZORE NË DREJTORINË E DOGANAVE

Gjatë vitit 2017 Drejtoria e doganave vazhdimisht ka investuar në promovimin dhe zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke numëruar burimet njerëzore për forcën lëvizëse në arritjen e synimeve strategjike të vendosura për integrimin në BE dhe përmirësimin e efikasitetit të punës së institucionit..

të punësuar 1.110 persona → (331 femra -29,82%, 779 meshkuj – 70,18%)


2 persona me status funksionari (drejtori dhe zëvendësdrejtori),

997 persona me status të nëpunësve doganor

11 persona me status të nëpunësve administrativ

dhe 100 persona me status të punëtorëve mbështetur në Ligjin për marrëdhënie pune.

Nga të cilët:



- Doktor shkencash – 2
- Magjistër – 41
- PLP – 637 (61%)
- Arsim i lartë – 17
- PMP – 393
- Tjerë – 24



III.1. KAPACITET I RI PËR ZHVILLIMIN E PERSONELIT KOMPETENT

Të punësuarit do të zhvillojnë dhe përmirësojnë jo vetëm njohuritë e tyre, por edhe aftësitë dhe sjelljet. I gjithë sistemi i menaxhimit dhe trajnimit të burimeve njerëzore të të punësuarve do të vazhdojë të përmirësohet dhe harmonizohet me Kornizën e Kompetencave Doganore të Komisionit Evropian. Në këtë mënyrë, nëpunësit e Drejtorisë së doganave do të përmbushin standardet evropiane si nëpunës doganor profesional.

Njohuri

x

Aftësi

x

Qëndrime


=

I punësuar
kompetent

III.2. TRAJNIME DHE PËRSOSJE PROFESIONALE GJATË VITIT 2017

Gjatë periudhës janar–dhjetër 2017 trajnime më të rëndësishme kanë qenë:

- Siguria e informacionit;
- Mbledhje pune mbi "Vlerësimin e rrezikut të korrupsionit në institucionet e sektorit publik – përcaktimin e rrezikut të korrupsionit dhe rreziqeve të tjera jo etike dhe planifikimin e zgjidhjeve dhe masave për kapërcimin e tyre“;
- Integriteti i nëpunësve administrativ;
- Seminar rajonal mbi hetimin e krimit kompjuterik dhe internetit.



III.3. KURSE RRETH TË MËSUARIT ELEKTRONIK

Si pjesë e aktiviteteve për harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian, Drejtorja e doganave filloi me përkthimin e kurseve rreth të mësuarit elektronik të Komisionit Evropian në lidhje me zbatimin e Ligjit Doganor të Bashkimit Evropian, i cili hyri në fuqi më 1 maj 2016. Këto kurse janë të destinuara si për nëpunësit doganor ashtu edhe për komunitetin e biznesit.



III.4. INTEGRITETI

Për ballafaqim të suksesshëm me korrupsionin, konfliktin e interesave dhe llojet e tjera të keqpërdorimit të detyrave zyrtare, ndërtimi dhe përmirësimi i integritetit të nëpunësit doganor dhe të Drejtorisë së doganave në tërësi është me rëndësi të veçantë.

- Mbështetur në Planin e aktiviteteve, ankesave të marra, informacioneve në linjën e hapur doganore 197, si dhe mbështetur në informacionet që dorëzohen ose në mënyrë të drejtpërdrejtë i prezantojnë udhëheqësit e njësive organizative dhe të punësuarit në Drejtorinë e doganave:



janë zbatuar 74 hetime të brendshme → në 23 raste janë konstatuar parregullsi dhe janë dhënë rekomandime për të mënjeluar të njëjtat

- Lidhur me veprimin e të punësuarve ndërsa mbështetur me dispozitat pozitive ligjore, aktet nënligjore dhe instruksionet operative të Drejtorisë së doganave,

janë zbatuar 44 kontrole të brendshme → nga të cilat në 16 raste janë konstatuar parregullsi

Përmes **linjës së hapur telefonike (197)**, janë pranuar **23 ankesa dhe 6 ankesa online** për veprime të paligjshme, joprofesionale dhe korruptive të nëpunësve doganor, përmes Shërbimit Raportues të Korrupsionit, janë pranuar në faqen e internetit të Drejtorisë së doganave.

- Fushata promovuese “**Ndalo Korrupsionin**” e kryer nga Drejtoria e doganave ka për qëllim ngritjen e vetëdijes publike për raportimin e rasteve të korrupsionit, konfliktit të interesave dhe abuzimit me autorizimet zyrtare të nëpunësve doganor. Në pamflete të shpërndara gjatë fushatës janë vënë në dukje efektet e dëmshme të shkaktuara nga korrupsioni, me prishjen e vlerave themelore sociale dhe keqpërdorimin e kapaciteteve institucionale në favor të interesave të paligjshme, dhe mënyrën në të cilën qytetarët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar propozimet korruptive duke raportuar raste të tilla.



- Që nga lëshimi në përdorim i **instrumentit të CAF**, si një nga mjetet më të mira për menaxhimin e cilësisë në institucionet, i cili miratoi Planin për përmirësimin e gjendjes në Drejtorinë e doganave, gjatë vitit 2017, 19 masa ose 52.8% janë implementuar dhe zbatuar plotësisht, në rrjedhën e realizimit janë 11 masa ose 30.5% të masave të përgjithshme të parashikuara.

III.5. REVIZIONI I BRENDSHËM

Gjatë vitit 2017 janë kryer:

17 revizione të brendshme → janë konfirmuar **60 konstatime** → janë dhënë **63 rekomandime për përmirësimin e punës**



IV. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I PROCEDURAVE DOGANORE

IV.1. KUSHTET PËR ZBATIMIN E FORMALITETEVE DOGANORE



Drejtoria e doganave në mënyrë intensive i fokuson aktivitetet e saj në zbatimin e praktikave të mira për të lehtësuar dhe përshpejtuar qarkullimin e mallrave nga dhe në Republikën e Maqedonisë. Ne punojmë gjithmonë në ruajtjen e mundësive ekzistuese dhe prezantimin e mundësive të reja për lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave dhe kushteve doganore për zbatimin e tyre, me mbështetjen e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Planet tona me qëllim që të lehtësohet dhe përshpejtohet qarkullimi i mallrave nga dhe drejt RM-së:

- Do të vazhdojmë me implementimin e reformave për lehtësim të tregtisë në drejtim të harmonizimit të plotë të legjislacionit vendor dhe procedurave me dispozitat e OBT-së dhe Protokollit 5 të CEFTA-s për lehtësim të tregtisë.
- Do të marrim aktivitete shtesë për implementimin e reformave për lehtësim të tregtisë përmes:
 - Qasjes më të madhe transparente deri te informacionet e nevojshme për import-eksport të mallrave;
 - Implementimit të zgjidhjeve të reja softuerike për përpunim të deklaratave doganore – pa letër dhe
 - Përfshirjes së sistemit për përcjellje të “pre-arrival” informacioneve që do të mundësojnë që të gjitha procedurat doganore të përfundojnë brenda vendit, ndërsa nëpërmjet kufijve dërgesat të kalojnë lirisht pa vonesa shtesë.
- Në mënyrë më aktive do të punojmë në konceptin e përfshirjes së operatorit ekonomik të autorizuar.
- Do të rishikojmë EXIM sistemin me çka do të kufizohet dhe reduktohet numri i patentave të nevojshme për importim dhe eksportim mallrave në lëvizje të lirë. .
- Do të formohen ekipe të përbashkëta për kontroll të pikave të kalimit kufitar me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të mallrave në kufi.

IV.1.1. Operatori i autorizuar ekonomik – OAE

Kompanitë e Maqedonisë do ti inkurajojmë që të marrin status të Operatorit të autorizuar ekonomik që të mund të përfshihen në zinxhirët e furnizimit në kuadër të CEFTA-s dhe të fitojnë njohje ndërkombëtare.



Me njohjen ndërkombëtare në kuadër të CEFTA-s, OAE të Maqedonisë do ti gëzojnë këto avantazhe:

- më pak kontrole teknike të sigurisë,
- njohje të partnerëve afarist si partner lojal në punën doganore,
- tretman prioritardhe mekanizëm për vazhdimsi të punës afariste.

Praktikisht, nëse një kompani maqedonase ka statusin e një OAE të njohur ndërkombëtarisht, kur eksporton mallra në ndonjë vend të CEFTA-s, do të ketë trajtim të një kompanie "vendore" siç janë kompanitë në vendin nikoqir.

Të njëjtin trajtim do të ketë OAE kur të importoj në Republikën e Maqedonisë.

Me integrimin e mëtejshëm në BE, ky proces i njohjes reciproke dhe ndërkombëtare do të zbatohet edhe për shtetet anëtare të BE

IV.1.2. Kontrole të përbashkëta kufitare – projekti "one stop shop"

Ky lloj kontrolli është një avantazh i madh në përsheptimin dhe lehtësimin e lëvizjes përgjatë kufirit shtetëror. Kjo është një zgjidhje e mundshme për të përsheptuar ndjeshëm kohën për përfundimin e formaliteteve kufitare ndoshta në një pikë të kalimit të përbashkët kufitar, me vetëm një ndalim dhe kontroll të udhëtarëve, mallrave dhe automjeteve. Prandaj, në perceptimin e të gjitha aspekteve (kapacitetet infrastrukturore, strukturën organizative, mundësinë e investimeve të tjera, etj), Drejtoria e doganave do të inicioj përfshirje në marrëveshjet ndërkombëtare në kalimet kufitare të veçanta të cilat do të realizohen në konceptin e kontroleve të përbashkëta kufitare..



IV.2. e-DOGANA

IV.2.1. Softuer i ri për përpunimin e deklaratave doganore

Projekti për përfshirjen e softuerit të ri për përpunimin e deklaratave doganore është pjesë e përpjekjeve për të përfshirë e-doganën. Ky sistem i ri është në fazën përfundimtare të testimit. Sipas planit deri në fund të vitit 2018, ky softuer, i cili është paralajmëruar gjatë kohës, i prolonguar dhe stërzgatur, do të vihet në veprim. Softueri i ri për përpunimin e deklaratave doganore duhet të zëvendësojë sistemin ekzistues ASYCUDA, të eliminojë vonesat e gjata, ndërprerjet dhe shkyçjet, dhe pamundësinë për të parashtruar deklaratat doganore në kohë

IV.2.2. EXIM



Sistemi elektronik me një sportel për lëshimin e patentave të importit dhe eksportit si dhe kuotave tarifore EXIM (në funksion nga viti 2008) nga viti në vit bëhet më i sofistikuar dhe mundëson një efikasitet më të madh në përshpejtimin e procedurave doganore, ndërsa vazhdimisht rritet edhe numri i përdoruesve të tij të regjistruar.

TË DHËNA STAISTIKORE RRETH PUNËS SË EXIM NË VITIN 2017

Numri i shteteve dhe institucioneve të involvuara – 17

Numri i patentave që mund të merret përmes EXIM – 60

6.710 Operatorë ekonomik të regjistruar – përdorues të sistemit

Patenta të importit, eksportit dhe transitit të lëshuara nëpërmjet EXIM – 91.593

Kërkesa për kuota tarifore të parashtruara përmes EXIM – 7.214

Koha mesatare për marrjen e patentës përmes EXIM – 1,6 orë

IV.3. FUSHËVEPRIMI I PUNËS

IV.3.1. Licencat doganore dhe të akcizës dhe licencat gjatë vitit 2017

Përfaqësimi në procedurat doganore

- Aprovimi për kryerjen e aktiviteteve të përfaqësimit në procedurat doganore → 248
- Personat fizikë – mbajtës të licencave për kryerjen e aktiviteteve të përfaqësimit në procedurat doganore → 1.143

Procedura doganore me efekt ekonomik

- Mbajtës të autorizimeve për përpunim të brendshëm → 172 shoqëri tregtare
- Mbajtës të autorizimeve për përpunim të jashtëm → 11 shoqëri tregtare
- Mbajtës të autorizimeve për deponimin doganor → 86 shoqëri tregtare
- Arovime të lëshuara me zbatim afatshkurtër → 5.574

Procedura të thjeshtësuara ekonomike – 215 aprovime për procedura të thjeshtësuara doganore nga të cilat:

- 48 aprovime për zhdoganim lokal për import,
- 68 aprovime për zhdoganim lokal për eksport,
- 60 aprovime për marrësin e autorizuar në transit,
- 32 aprovime për dërguesin e autorizuar dhe
- 7 aprovime për deklarimin e thjeshtëzuar.

Informacione të detyrueshme tarifore (IDT) → 575

Aprovime për eksportues të miratuar → gjatë vitit 2017 janë lëshuar 9 aprovime të reja për eksportues të miratuar. Numri i përgjithshëm i aprovimeve të lëshuara për eksportues të miratuar përfundimisht me dhjetorin e vitit 2017 → 140 → aktiv 130

Aprovime për pagesa të prolonguara → 192

Aprovime për përdorimin preferencial të akcizës dhe patenta të akcizës

- *Aprovime për përdorimin preferencial të akcizës nga operatorët ekonomik* → 313
- *Patenta aktive të akcizës nga operatorët ekonomik* → 78.

IV.3.2. Deklarata të procesuara doganore - 1,02 milion deklarata doganore

- *Të importit (rreth 44,59%)*
- *Të transitit (rreth 31%),*
- *Të eksportit (rreth 21,80%) dhe*
- *Ri-eksport (rreth 2,61% nga totali i deklaratave të procesuara).*

Pjesëmarrja në procedurat e thjeshtësuara nga totali i procedurave të importit dhe eksportit arrin 27,96%.

IV.4. QARKULLIMI I AUTOMJETEVE MOTORIKE TË MALLRAVE (AAM) NË PIKAT E KALIMEVE KUFITARE GJATË VITIT 2017

Në pikat e kalimeve kufitare për qarkullim rrugor ka transituar një total prej 839 mijë AAM → 454 mijë të mbushura, dhe rreth 385 mijë AAM të zbrazura.

Qarkullimi më i madh është realizuar në pikat e kalimit kufitar me Greqinë, edhe atë rreth 308 mijë AAM ose rreth 37%. Qarkullimi më i madh nëpër pikat e kalimeve kufitare individuale është realizuar në PKK Bogorodicë me 23% nga qarkullimi total.



IV.5. PAGIMI I TË HYRAVE

Gjatë vitit 2017 Drejtoria e doganave me sukses ka realizuar qëllimin që të mbroj interesat financiare të shtetit përmes sigurimit të mbledhjes së të hyrave buxhetore në kohë dhe në mënyrë efikase.



Gjatë vitit 2017 Drejtoria e doganave ka realizuar planin për pagesë të të hyrave publike. Më saktësisht, gjatë vitit 2017 Drejtoria e doganave sipas të gjitha bazave ka mbledhur një total prej 78.214,26 milion denarëve, respektivisht 1.267,7 eurove. Kjo shumë është:


- më e madhe për 2% në drejtim të të hyrave të planifikuara 76.678,00 milion denarëve dhe
- më e madhe për 7,2% në drejtim të hyrave të realizuara gjatë periudhës janar–dhjetor 2016 në shumë prej 72.941,80 milion denarëve

Plani i pagesës për vitin 2017, krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti 2014 deri më 2016:

në miliona denarë

PERIUDHA	Plani 2017	Realizuar 2017	Realizuar 2016	Realizuar 2015	Realizuar 2014
Janar–dhjetor	76.678,00	78.214,26	72.941,80	67.233,68	63.064,30
INDEKSI	Pagesa /plani 2017		2017/2016	2017/2015	2017/2014
Periudha 2017/'16/'15/'14	2,0%		7,2%	16,3%	24,0%

TË HYRA TË PAGUARA – DDRM për vitin 2017



Të hyra të paguara	DDRM 2017	(në mil. denarë)
DOGANA		5.174,7
TVSH nga importi		46.060,9
AKCIZA		26.314,9
KOMPENSIME		663,7
TOTALI I PAGUAR 2017		78.214,3
TOTALI I PAGUAR 2016		72.941,8
2017/16	+7,2 %	
TOTALI I PLANIFIKUAR 2017		76.678,0
2017/plani	+2,0 %	

- **DOGANA** – 5,17 miliard denarë, që është për 8,7% më shumë në raport me vitin 2016, kur janë paguar 4,76 miliard denarë.
- **TVSH** – 46,06 miliard denarë, që është për 9,4% më shumë në raport me vitin 2016, kur janë paguar 42,09 miliard denarë.
- **AKCIZA**– 26,31 miliard denarë për akciza, që është për 3,6% më shumë në raport me vitin 2016, kur janë paguar 25,4 miliard denarë.
- **KOMPENSIME** – 0,66 miliard denarë në emër të kompensimeve, që është për 2,5% më pak në raport me vitin 2016, kur janë paguar 0,68 miliard denarë.

Drejtoria e doganave përmes të hyrave që i grumbullon ka marrë pjesë me 73% nga totali i të ardhurave të planifikuara tatimore për vitin 2017.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja jonë e të hyrave të paguara në totalin e të hyrave në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2017 arrin 42%.



V. KONTROLLI DHE ZBATIMI I LIGJEVE

Qasja moderne në punë kërkon që roli dhe detyrat e Doganës të integrohen në një sistem të vetëm për sigurinë dhe kontrollin e kufirit, duke siguruar funksionin e sigurisë në mënyrë efektive kundër krimit të organizuar ndërkuftar, terrorizmit, pastrimit të parave, kontrabandës, migracionit ilegal dhe trafikimit të qenieve njerëzore .

V.1. KONTROLLI DOGANOR DHE KONTROLLI TJETËR

V.1.1. Kontrolli doganor fizik

Vitin e kaluar 2017 kemi pasur 289 tentativa të suksesshme, ku janë zbuluar dhe sekuestruar 1.304 kilogram drogë, 222 kilogram duhan i grimcuar dhe 270 mijë copë cigare, 346 litra, 5.661 copë dhe 22.178 kilogram lloje të ndryshme të produkteve ushqimore, 56 mijë copë ilaçe, deviza në shumë ekuivalente prej 545 mijë eurove dhe mall tjetër.



Zbulohen raste të tregtisë ilegale me droga narkotike, substanca psikotropike dhe prekursorë

Gjatë vitit 2017 janë penguar 31 tentativa për kontrabandë të rreth 1.304 kilogramëve të drogës narkotike – marihuanë, ekstaza, hashash, LSD, farë marihuane, kokainë dhe heroinë.



Në pikën e kalimit kufitar Bllacë gjatë hyrjes në vend sekuestrohet afro 1 ton marihuanë



Në pikën e kalimit kufitar Bllacë gjatë hyrjes në vend sekuestrohen 66,5 kg marihuanë



Në pikën e kalimit kufitar Bllacë gjatë hyrjes në vend sekuestrohen 22 kg marihuanë.



Në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë gjatë hyrjes në vend sekuestrohen afro 7 kg heroinë.



Në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë gjatë hyrjes në vend sekuestrohen afro 1 kg heroinë

Zbulohen raste të kontrabandës me cigare dhe prodhime tjera duhani

Në 25 raste gjatë vitit 2017, nëpunësit doganor kanë penguar kontrabandë të rreth 270 mijë copave cigare dhe 222 kilogramëve të duhanit të copëtuar. Gjatë zbulimit të cigareve është përdorur pajisja e dhuruar përmes Programit EXBS dhe ambasadës së SHBA-ve.



200 kilogram duhan për llullë me ujë të cilat zbulohen në një automjet motorik të mallrave në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë, gjatë hyrjes në vend



26.000 cigare me pulla akcize të Maqedonisë zbulohen në PKK Bogorodicë në tankun e gazit të automjetit

Pengohen tentativa për kontrabandë të ushqimit

Gjatë vitit 2017 pengohen 22 tentativa për kontrabandim të 22.178 kilogramëve, 5.661 copëve dhe 346 litrave të llojeve të ndryshme të produkteve ushqimore



Rreth 9 ton domate dhe tranguj zbulohen në zyrën doganore Gjevgjeli



84 kg mish i thatë dhe suxhuk zbulohen në pikën e kalimit kufitar Bllacë.

Zbulohen raste të kontrabandës me ilaçe

Në 10 raste gjatë vitit 2017, pengohet kontrabandë e rreth 56 mijë ilaçeve.



Në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë zbulohen 2.184 ilaçe



19.245 ilaçe zbulohen gjatë kontrollit të një autobusi në pikën e kalimit kufitar Bllacë.

Pengohen tentativa për bartje ilegale të parave të gatshme dhe letrave me vlerë

Në 51 raste gjatë vitit 2017, nëpunësit doganor penguan bartje ilegale të afro 545 mijë eurove.



Zbulohen dhe merren 105.000 euro te një udhëtar në pikën e kalimit kufitar Aeroport, gjatë daljes nga vendi



155.000 kruna daneze gjenden te një udhëtar në pikën e kalimit kufitar Aeroport, gjatë daljes nga vendi.

Zbulohen raste të kontrabandës së mallit të ndryshëm

Gjatë vitit 2017, nëpunësit doganor penguan 157 tentativa të kontrabandës së 25 tonëve, 222 litrave dhe 50,600 copash të mallit të ndryshëm



1 pistoletë, 4 cilindra gazi dhe 120 diabola metalike, zbulohen gjatë kontrollit të një autobusi turistik gjatë hyrjes në vend në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë.



Në pikën e kalimit kufitar Deve Bair gjatë hyrjes në vend zbulohen 980 copë orë të padeklaruar.

V.1.2. Kontrolli i dokumentuar doganor

Në 30.874 raste zbulohen dokumente jopërkatese me të cilët importuesit kanë tentuar që të shmangin pagesë të rreth 1.059 milion denarëve në emër të detyrimeve të importit.

V.2. REZULTATE TË KONTROLLIT POST-DOGANOR

Kontrolli post-doganor përfshin kontroll të shoqërive tregtare pas zhdoganimit, si dhe kontroll të mbajtësve të aprovimeve për procedura doganore me efekt ekonomik, aprovime për procedura të thjeshtsuara doganore, patenta akcize etj.

Gjatë vitit 2017 janë bërë 144 kontrolle të shoqërive tregtare ku janë zbuluar:

- 41 tentativa për shmangje të pagesës së detyrimeve të importit në shumë totale prej rreth 24.16 milion denarë. Në 19 raste është konstatuar mospërmbajtje ndaj detyrimeve nga aprovimi i lëshuar për import përpunimi, deponim doganor dhe importues me aprovim.
- Nga 32 përdorues të kontrolluar të naftës së lëngshme si karburant motorik, në 7 raste janë zbuluar kërkesa për kthim të akcizës në shumë më të madhe se ajo e parapara me ligj. Gjatë 9 kontrolleve të tregtarëve të regjistruar me vajra minerale që përmbajnë materie për shënim të karburanteve janë zbuluar 4 raste të shkeljes së Ligjit për akciza dhe Ligjit për energjetikë.
- Gjatë 33 kontrolleve të bartësve të patentave të akcizës janë zbuluar 6 raste të shumës më pak të paguar prej 5.744.888 denarëve dhe 6 raste të mospërmbajtjes me detyrimet e patentës së akciës ose aprovimit. Për kundërvajtjet e zbuluara janë ngritur procedura përkatëse të kundërvajtjes.

V.3. PAGESA SHITESË E DETYRIMEVE TË IMPORTIT DHE AKCIZËS

Gjatë vitit 2017 janë sjellë 1.438 vendime në emër të pagesës shtesë të detyrimeve të importit dhe TVSH-së, në shumë totale prej rreth 244,48 milion denarëve.

V.4. KALLËZIME PENALE

60 kallëzime penale kundër 67 personave fizik dhe 29 personave juridik.

Struktura e veprave penale është e shumëllojshme, ndërsa më së shpeshti bëhet fjalë për prodhim të paautorizuar dhe qarkullim të narkotikëve (20 raste) mashtrim doganor (17 raste) cenim i të drejtave të pronësisë intelektuale (14 raste), falsifikim dokumentacioni (11 raste) etj.

V.5. KUNDËRVAJTJE DOGANORE, ME DEVIZA DHE AKCIZA

Gjatë vitit 2017:

- Janë parashtruar **384 kallëzime kundërvajtëse** (325 për kundërvajtje doganore, 49 për deviza dhe 10 për kundërvajtje me akciza. (Nga totali i kallëzimeve të parashtruara 345 kanë të bëjnë me persona fizik dhe 39 me persona juridik).
- Janë zgjidhur **401 lëndë kundërvajtëse** (ku kryerësve u janë shqiptuar gjopa në shumë prej 22,65 milion denarëve)
- Janë shqiptuar **2.228 dënime mandati** kundër 1.355 personave fizik dhe 873 personave juridik (ku kryerësve u janë shqiptuar dënime në vlerë prej 22.77 milion denarësh).

V.6. PJESËMARRJE NË OPERACIONE NDËRKOMBËTARE

Kemi marrë pjesë në 14 operacione ndërkombëtare, organizuar nga Organizata botërore e doganave, Evropoli, Interpoli, Fronteksi, Zyrat rajonale të inteligjencës për lidhje (RILO AP, RILO ECE), SELEK etj.

V.7. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Një nga prioritetet kryesore të Drejtorisë së doganave është avancimi i kapacitetit institucional dhe administrativ për luftë më efikase dhe efektive kundër falsifikimit dhe piraterisë, përmes përfshirjes së masave më të rrepta të kontrollit doganor për zbulimin dhe pengimin gjatë importit, transitit dhe eksportit të mallrave që cenojnë të drejtën e pronësisë intelektuale, si dhe bashkëpunimit të rritur me bartësit e kësaj të drejte dhe përfaqësuesit e tyre në Republikën e Maqedonisë, nga njëra anë, si dhe me të gjitha institucionet kompetente në vend dhe jashtë, nga ana tjetër.



Gjatë vitit 2017:

- Përkohësisht janë mbajtur 721.093 copë mall, zbuluar në 56 aksione nga dyshimi se cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Pas konfirmimit të cenimit të së drejtës së pronësisë intelektuale, nën mbikëqyrje doganore janë asgjësuar 415.300 copë produkte të falsifikuara: vezë çokollate, sheqerka çokollate, çorape, 11.886 produkte ushqimore (tullumba, bakllava, dhe ëmbëlsira) veshmbathje, pajisje për automobila, deodorantë, orë, pajisje diagnostifikimi për automjete motorike, telefona celular etj.
- Numri i kërkesave të regjistruara për mbrojtje doganore të markave tregtare në drejtim të të drejtave të pronësisë intelektuale arrin 970
- Janë konstatuar sasi të reja për dorëzim të mallit të sekuestruar nga depot e Drejtorisë së doganave (1,908 palë këpucë, 920 bluza, 460 këmisha, 170 bluza me mëngë të shkurtra, 156 palto, 100 xhinse, 80 streça etj.) për të cilat ekziston mundësia ligjore për dorëzim falas mbështetur me dispozitat pozitive ligjore. Ky mall më pas do ti dorëzohet Ministrisë për punë dhe politikë sociale për shpërndarje nëpër kategoritë sociale të popullsisë ose për ata që vuajnë pasojat e katastrofave natyrore.



VI. TRANSPARENCË DHE BASHKËPUNIM NË FUSHËN E DOGANËS

Transparenca paraqet një institucion vendimtar në vendosjen e marrëdhënieve të mira me të gjitha grupet e synuara dhe ndërtimin e publicitetit të favorshëm, imazhin e mirë institucional dhe parandalimin ose zgjidhjen e dukurive të padëshirueshme.

VI.1. NGJARJE TË RËNDËSISHME

- Shënimi i **26 janarit** – Ditës ndërkombëtare të doganës që është shënuar nën sloganin “analiza e të dhënave për menaxhim kufitar” Mirënjohje nga z. Kunio Mikurija, Sekretar gjeneral i OBD-së, u janë ndarë 12 nëpunësve doganor për angazhimin edhe kontributin e tyre.
- Drejtorja e doganave shënoi **25 vite** nga ekzistimi i saj si organ i pavarur shtetëror, kështu duke organizuar organizim tradicional solemn dhe organizoi aksion për **dhurim të gjakut** ku si shenjë humanizmi dhuruan mbi 150 nëpunës doganor.
- Gjatë muajit prill është promovuar fushata “**Stop produkteve të falsifikuara**” me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për dëmet që mund të shkaktojnë produktet e falsifikuara.
- Në shtator të vitit 2017 në një ceremoni solemne në pikën e kalimit kufitar Bllacë, **Ambasada e SHBA-ve** përmes Programit EXBS¹ dhe Programit ndërkombëtar për ndihmë dhe trajnime gjatë hetimeve kriminale (ICITAP²), dhuroi pajisje destinuar për pengimin ilegal të tregtimit me mallra. Donacioni, në vlerë totale prej 207 mijë dollarëve amerikan përfaqësoi pajisje



WORLD CUSTOMS ORGANIZATION
ORGANISATION MONDIALE DES DOUANES



¹ EXBS Program – Export Control and Related Border Security Program – (Programi për kontroll të eksportit dhe sigurisë kufitare)

² ICITAP – International Criminal Investigative Training Assistance Program (Programi ndërkombëtar për asistencë dhe trajnime gjatë hetimeve kriminale në Ministrinë e drejtësisë së SHBA-ve)

për pengim të krimit ndërkufitar (videoskop, buster, pejxher për zbulim të radioaktivitetit dhe vegla), kompjuterë, automjet patrullimi dhe automjete terreni.



- Gjatë periudhës prej 30 nëntorit deri më 1 dhjetor të vitit 2017, Drejtoria e doganave me mbështetjen e USAID dhe Bankës botërore/IFC, në Shkup mbajti Mbledhje rajonale joformale të drejtorëve të Drejtorive të doganave të Ballkanit perëndimor. Qëllimi kryesor i mbledhjes ishte gatishmëria e qasjes së përbashkët të Shërbimeve doganore nga rajoni me qëllim avancimin e bashkëpunimit ekonomik në Ballkanin perëndimor.



VI.2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Pjesëmarrje e delegacionit të Drejtorisë së doganave në:

- **Mbledhje të organeve më të larta të Organizatës botërore të doganave: seancë e Këshillit për bashkëpunim doganor dhe mbledhje e drejtorëve të shërbimeve doganore nga rajoni Evropian.** Në margjina të seancës së Këshillit është nënshkruar **Protokoll për shkëmbimin e dokumenteve dhe informacioneve lidhur me vlerën doganore të mallit dhe Plan pune për realizimin e të njëjtit me Federatën Ruse.**
- **Seminar në nivel të lartë të strategjisë afatgjate për implementim të sistemeve doganore TI mbajtur në shtator të vitit 2017 në Talin – Estoni. .**



- Mbledhje e 14 e Nën komitetit për tregti, industri, doganë dhe taksim që është mbajtur në Bruksel në nëntor të vitit 2017.
- Mbledhje e 30 e Komisionit të përzier BE-EFTA për transitin e përbashkët dhe thjeshtësimin gjatë tregtimit të mallit. Mbajtur në dhjetor të vitit 2017 në Oslo, Norvegji.

VI.3. BASHKËPUNIMI BILATERAL



Në tetor të vitit 2017 në vizitë zyrtare të Drejtorisë së doganave të Republikës së Maqedonisë qëndroi delegacioni i Drejtorisë së doganave të Republikës së Kroacisë, udhëhequr nga z-Hrvoje Çović, drejtor gjeneral dhe ndihmës ministër i financave. Ky takim ishte shumë i rëndësishëm për fitimin dhe shkëmbimin e përvojave në më shumë fusha, me qëllim plotësimin e kushteve të nevojshme për anëtarësim në BE.



Në nëntor të vitit 2017 në Beograd është mbajtur takim bilateral mes delegacioneve të Drejtorive të doganave të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Serbisë. Takimi i delegacioneve udhëhequr nga drejtorët e të dy shërbimeve është mbajtur për përmirësimin e bashkëpunimit mes dy vendeve.

VI.4. BASHKËPUNIMI I KOMUNITETIT TË BIZNESIT

Bashkëpunimi i ndërsjellë i komunikimit të konkurrencës me të gjithë operatorët ekonomik është i rëndësishë së veçantë për Drejtorinë e doganave dhe në këtë drejtim gjatë vitit 2017 janë realizuar takime të shumta me komunitetin e biznesit.

- Në shtator të vitit 2017 janë mbajtur më shumë takime pune me komunitetin e biznesit
 - Takim pune me përfaqësues të Grupacionit të përpunuesve të mishit dhe prodhimit të përpunimit të mishit si rezultat i nevojës për rritje të konkurrencës së kompanive vendore që bëjnë përpunimin e mishit;
 - Takim pune me përfaqësues të Sektorit të tekstilit, ku është diskutuar rreth sfidave me të cilat ballafaqohet industria e tekstilit në punën e saj, si dhe për mundësitë për zbatim më të mirë të procedurave doganore dhe legjislacionit në drejtim të lehtësimit të punës së sektorit të tekstilit.
 - Në amfiteatrin e Drejtorisë së doganave është mbajtur takim pune ku morën pjesë një numër i madh i përfaqësuesve të komunitetit të biznesit;



- Drejtori i Drejtorisë së doganave mori pjesë në seancën e Bordit drejtues të **Odës ekonomike Maqedonase-turke (MATTO)**, me qëllim të njohjes me anëtarët e Bordit drejtues si dhe diskutim rreth temave aktuale të punës tregtare mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë.



- Në bashkëpunim me ministrin pa resor, kompetent për legjislacionin për klimën e investimeve të kompanive vendore, **në tetor të vitit 2017** në Drejtorinë e doganave **është mbajtur takim pune me përfaqësues të afro 15 kompanive vendore**. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve tjera të shtetit me qëllim të shkëmbimit të mendimeve dhe në mënyrë të përbashkët të gjenden zgjidhje më adekuate për problemet dhe nevojat e kompanive vendore.
- Në hapësirat e Drejtorisë së doganave **në nëntor është mbajtur prezantim i iniciuar nga odat ekonomike dhe mbështetur nga një profil i më shumë pjesëmarrësve** (importues, eksportues, përfaqësues në procedura doganore dhe profesorë) ku është prezantuar udhërrëfyti ku do të kalojnë dispozitat e punës doganore gjatë periudhës 5 vjeçare.
- **Drejtoria e doganave dhe Universiteti “Nënë Tereza” në nëntor të vitit 2017 nënshkruan “Memorandum për bashkëpunim”** ku shprehën qëllimin e palëve nënshkruese për bashkëpunim të ndërsjellë dhe qëllimin e përbashkët për vendosjen e bashkëpunimit afatgjatë në fushën e teknikës, arsimit dhe shkencës përmes organizimit dhe performimit të praktikës mësimore për studentët e Universitetit në suaza të veprimtarisë së tij dhe hulumtime shkencore nga fusha e punës doganore.

VI.5. INTERNET DHE INTRANET

Drejtoria e doganave zhvilloi një faqe të re interneti, mbështetur me zgjidhjet më të reja teknologjike si dhe parimet e transparencës dhe llogaridhënies së punës së saj, ndërsa me qëllim të ndarjes efikase të informacioneve deri te publiku më i gjerë si dhe përmirësimin e të menduarit pozitiv përmes promovimit të punës së saj dhe rezultateve të arritura. Faqja e re e internetit është lëshuar në përdorim në maj të vitit 2017, ndërsa për herë të parë ka qenë e qasshme edhe në këtë domen cirilik: „царина.мкд“. Në mënyrë plotësuese është rritur mundësia për qasje deri te informacionet edhe për personat me invaliditet, me përfshirjen e standardit për qasje uebi³.



³ WCAG 2.0 (<http://wcag.mioa.gov.mk>)



Përgatiti dhe botoi:
DREJTORIA E DOGANAVE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Rr. Lazar Liçenovski 13, 1000 Shkup
www.customs.gov.mk

Dizajnoi dhe shtypi:
Evropa 92 – Koçanë
Tirazhi:
30 ekzemplarë



